



DOWN SYNDROME KOSOVA - MITROVICË

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E MITROVICËS-OPSTINA MITROVICA	
01 Nr.Pro/L/Br.Prot.	02-400/04-0044507/75
Nr i fq./Br.str	29.07.75
Data/Datum	
Selja/Ins	Mitrovicë - Mitrovica

Nga: Shoqata Down Syndrome Kosova – Mitrovicë

Për: Kryesuesen e Asamblesë Komunale në Mitrovicë të Jugut

Lënda: Kërkesë për mbështetje institucionale dhe financiare për shërbimet sociale për persona me sindromën Down

Personi kontaktues: Xhenis Beqiri – menaxher qendre
xhenis.beqiri@downsyndromekosova.com
+38349 883 053

Shoqata Down Syndrome Kosova (DSK) është shoqatë multietnike dhe kombëtare e komunitetit të personave me sindromë Down, e themeluar nga prindërit e fëmijëve me sindromën Down në mars 2007. DSK është shoqatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e cila ka fushëveprim në të gjithë Kosovën përmes qendrave të saj të vendosura në pesë qytete të mëdha Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Deri më sot, shoqata ka arritur të mobilizojë më shumë se 1,000 anëtarë të komunitetit, për të organizuar iniciativa për promovimin dhe realizimin e të drejtave të barabarta për personat me sindromë Down dhe ato të Personave me Aftësi të Kufizuara në përgjithësi. Tutje, DSK, ka për mision promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me sindromë Down në Kosovë dhe familjarëve të tyre.

Kërkesë

E nderuar znj. Kryetare,

Shoqata Down Syndrome Kosova – Qendra në Mitrovicë, ofron shërbime të specializuara logopedike, psikologjike, psiko-sociale dhe të terapisë së zhvillimit për 58 persona me sindromën Down nga komuna e Mitrovicës. Në këtë kuadër, ju drejtohet me këtë shkresë për të kërkuar mbështetjen tuaj dhe të Asamblesë Komunale, në funksion të sigurimit të vazhdimësisë së shërbimeve esenciale për këtë grup të qytetarëve.

Siç mund të jeni në dijeni, deri më sot nuk është shpallur thirrja publike për shërbime sociale për vitin 2025, edhe pse ndodhemi tashmë në gjysmën e dytë të vitit. Më datë 19 qershor



**DOWN
SYNDROME
KOSOVA - MITROVICË**

2025, kemi dorëzuar një kërkesë zyrtare në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, përmes së cilës kemi kërkuar sqarime për vonesën dhe afatet e mundshme të publikimit të thirrjes. Fatkeqësisht, nuk kemi marrë asnjë përgjigje zyrtare deri më sot.

Gjatë pjesëmarrjes sonë në dëgjimin publik për Buxhetin Afatmesëm për vitin 2026, kemi marrë konfirmim nga Drejtorja e Financave dhe Buxhetit se komuna ka mjete të planifikuara për mbështetjen e shërbimeve sociale për vitin 2025. Për këtë arsye, vonesat në publikimin e thirrjes përbëjnë rrezik real për ndërprerjen e shërbimeve dhe për mosrealizimin e buxhetit të ndarë për këtë qëllim.

Në këtë kontekst, ju lutemi që si Kryetare e Asamblesë Komunale të:

1. Adresoni urgjencën e kësaj çështjeje në nivel të Asamblesë, përmes diskutimit institucional dhe kërkesës për llogaridhënie nga drejtoria përkatëse;
2. Mbështetni në mënyrë të drejtpërdrejtë ndarjen e mjeteve financiare nga Komuna për shërbimet sociale për persona me sindromën Down, në kuadër të planifikimeve aktuale buxhetore ose përmes formave të tjera të financimit të mundshëm.

Shoqata jonë është duke mbuluar me kapacitete të kufizuara një nevojë reale dhe të qëndrueshme të komunitetit, dhe çdo vonesë institucionale ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe zhvillimit të përfituesve tanë. Për këtë arsye, konsiderojmë se përkrahja juaj dhe e Asamblesë është thelbësore për të garantuar respektimin e të drejtave dhe nevojave të personave me aftësi të kufizuara në komunën tonë.

Me besim në mirëkuptimin dhe përkushtimin tuaj, mbetemi në pritje të përgjigjes suaj.

Me konsideratë të lartë,

Xhenis Beqiri



**DOWN
SYNDROME
KOSOVA - MITROVICË**

Shoqata Down Syndrome Kosova, Qendra Mitrovicë

28/07/2025

Vendbanini / Продавщице / Residence


Mr. Lm: Bo, A. K. / ID Card No.

Mr. Personal / निम्न बंद / Personal No.

MPB / MUP / MIA

10.05.2022

Data e leshimit / Data e marrëdhënies / Date of issue





OJQ "Zëri i Prindërve", Muzeu i Qytetit pn, Mitrovicë, 400pn.
Tel. +38349454059; 044412196 zeriprindrve@yahoo .com

KËRKES

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA	
01 Nr.Prot./Br.Prot.	02-400/04-0072816/25
Nr i fq./Br.str	
Data/Datum	22-07-2025
Person/ins	Mitrovicë - Mitrovica

Për : Kuvendin Komunal në Mitrovicë

Nga : Shoqata e të zhdukurve dhe viktimave civile me seli në Mitrovicë
Ju drejtohem me kërkesën për perkrashje financiare për aktivitetet e shoqatës përkrashjen e familjarëve ,mirmbajtjen e zyres ku kujdestarohet prej 8.00h deri në 16.00h kërkojm nga 500.00 euro (pesëqindëeuro)

Shoqata zeri i Prindërve i drejtohet Kuvendit Komunal me fjalet se mungesa e mjeteve financiare janë mungesa e aktiviteteve të familjareve kontaktet , mjete për administrat për zyre janë munges e madhe në shoqat nuk kemi burime prej 2024 ju lutemi na merrni parasysh për perkrashje kjo shoqat është në të mirën e popullatës së Mitrovicës ku na mungojn nr i madh i njerzve të zhdukur në Luftën 1998-99 nr total i të zhdukurve ende në listë 104 persona.

Mbesim me shpres se do të na merrni parasysh kërkesën tone, me nga 500.00 euro

Ju faleminderit për Mirkuptim

NLB Banka 17-07-0016 0001 2586

Gjyla Haziri nr. Pers.1000903970


Zeri i Prindërve

Data : 21.07.2025

Mitrovicë



Kryetare e shoqatës Zeri i Prindërve

 Gjyla Haziri

SHOQATA E INVALIDËVE TË LUFTES TË UÇK
THE SOCIETY OF WAR INVALIDS MEMBERS
OF THE KLA

Nr. 3
Dt. 21.07.2025
MITROVICË

**SHOQATA E INVALIDËVE TË LUFTËS
TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E MITROVITSE-MITROVICA	
01 Nr. Prot./Br. Prot.	<u>07-400/04-0047658/15</u>
Nr i fq./Br. str.	<u>21.04.75</u>
Data/Datumi	
Sela/Ins	<u>Mitrovicë - Mitrovica</u>

**THE SOCIETY OF WAR INVALIDS
MEMBERS OF THE KLA**

SHOQATA E INVALIDËVE TË LUFTËS TË UÇK-së DEGA NË MITROVICË

Për- Kuvendin Komunal në Mitrovicë

Nga- Shoqata e Invalidëve të luftës të UÇK-së Dega në Mitrovicë

Lënda- Kërkes për mbështetje financiare për aktivitete e mirmbajtje të zyres të
Shoqates, kërkojm 500.00 euro (pesqind euro)

Shoqata e Invalidëve të luftës të UÇK-së Dega në Mitrovicë kërkon nga Kuvendi Komunal në Mitrovicë kërkojm 500.00 € (pesqind euro) për aktivitete e mirmbajtje te zyres te Shoqates të Invalidëve te luftës së UÇK-së Dega në Mitrovicë.

Shoqata e Invalidëve të luftës të UÇK-së Dega në Mitrovicë ka veshtersi financiare në realizimin e aktiviteteve si dhe në mirmbajtjeje të zyres e administrates së shoqates, per arsye se nuk kemi një mbeshtetje te perhershme financiare, prandajë kërkojmë nga Kuvendi Komunal të na perkrahin me mjete financiare, që shoqata të mundë të kryej aktivitetet e veta.

Me respekt nga SHIL-UÇK-së Dega në Mitrovicë

Idedikohet:

1x- Kuvendit Komunal në Mitrovicë
1x-Arkivit të SHIL-UÇK-së Mitrovicë

Numri kontaktues 044-342-302



Kryetari i SHIL-UÇK-së
Dega në Mitrovicë
Z. Naser Islami



**ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS
TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS**
MITROVICË



OVL – UCK


Nr. Prot.

14 / 2025

Data.

21. 07. 2025

Mitrovice



ORGANIZATA E VETERANEVE TE LUFTES SE UCK –se, DEGA NE MITROVICE

Per: Kuvendin Komunal ne Mitrovice

Nga: Organizata e Veteranve te uftes se UCK – se, Dega ne Mitrovice

Lenda – Kerkes per mbeshtetje financiare per aktivitete e mirembajtje te zyrave te Organizates, Kerkojm 500,00.euro (peqind euro)

Organizata e Veteranve te luftes se UCK – se, dega ne Mitrovice kerkon nga Kuvendi Komunal n e Mitrovice, 500,00.euro (peqind euro) per aktivitete e mirembajtjes te zyres te Organizates se Veteranve te luftes se UCK – se, Dega ne Mitrovice.

Organizata e Veteranve te luftes se UCK – se, Dega ne Mitrovice ka veshtiresi financiare ne realizimin e aktiviteteteve si dhe ne mirembajtje te zyres e administrates se organizates per arsye se nuk kemi nje mbeshtetje te perhershme financiare, prandaj kerkojme nga

Kuvendi Komunal te na perkrahin me mjete financiare, qe organizata te munde te kryej aktivitetet e veta.

Me respekt nga OVL – UCK – se Dega ne Mitrovice

I dedikohet:

1X- Kuvendit Komunal ne Mitrovice

1X- Arkivit te OVL – UCK – se Dega ne Mitrovice

Numri kontaktues, 043- 733-785

Kryetari I OV – UCK – se
Dega ne Mitrovice
Z. Rafet Ibishi

SHOQATA E FAMILJEVE TË DESHMOREVE TË UÇK-së
ASSOCIATION OF FAMILY MEMBERS OF UÇK MARTIRS

Nr. 35
Dt. 21.07.2025
DEGA MITROVICË — GRANCH MITROVICA



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E MITROVICË - OPSTINA MITROVICA

01 Nr. Prot./Br. Prot. 02-400/04-0042644/15
Nr i fq./Br i str. 21.07.15
Data/Datumi
Sela/Ins Mitrovicë - Mitrovica

SHOQATA E FAMILJEVE TE DESHMOREVE TE UFTES SE UCK – se, DEGA NE MITROVICE

Per: Kuvendin Komunal ne Mitrovice

Nga: Shoqata e Familjeve te Deshmorve te Luftes se UCK – se, Dega ne Mitrovice

Lenda – Kerkes per mbeshtetje financiare per aktivitete e mirembajtje te zyres te

Shoqates, kerkojm 500.00.euro (pegind euro)

Shoqata e Familjeve te Deshmoreve te Luftes se UCK – se, Dega ne Mitrovice kerkon nga Kuvendi Komunal ne Mitrovice 500,00.euro (Pesqind euro) per aktivitete e mirembajtjes te zyres te Shoqates se Familjeve te Deshmoreve te luftes se UCK – se, Dega ne Mitrovice.

Shoqata e Famijeve te Deshmoreve te Luftes se UCK – se, Dega ne Mitrovice ka veshtiresi financiare ne realizimin e aktiviteteve si dhe ne mirembajtje te zyres e administrates se shoqates, per arsye se nuk kemi nje mbeshtetje te perhershme fiannciare, prandaj kerkojme nga

Kuvendi Komunal te na perkrahin me mjete financiare, qe shoqata te munde te kryej aktivitetet e veta.

Me respekt nga SHFD – UCK – se, Dega Ne Mitrovice

I dedikohet:

1X – Kuvendit Komunal ne Mitrovice

1X – Arkivit te SHFD – UCK – se, Dega ne

Numri kontaktues 044 355 376



Kryetarja e SHFD – UCK – se,
Dega ne Mitrovice
znj. Alie Gashi - Tmava



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0041977-1/25 dt. 25.07.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 43-të

Koha: 25.07.2025 ora 10:00
Vendi: Salla e Mediave
Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhylljeta Imeri
Nënkryetari i Komunës z. Arian Tahiri
Drejtorët e Drejtorive
Mungoi: Shkurta Shosholli Musa

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e 43-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2025

Rendi i ditës u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 2

Kryesuesja e Kuvendit hapi diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2025.

Fadil Veseli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Do të përpiqem të përmend në pika të shkurtra disa specifika nga raporti gjashtëmujor i vitit 2025. Do të fillojmë me të hyrat vetanake sipas tabelës numër 1. Realizimi i të hyrave vetanake për gjashtëmujorin është dy milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro. Nëse e krahasojmë me planifikimin vjetor, kjo përbën rreth 55.74%. Mirëpo, nëse e ndajmë në dy pjesë, që do të thotë dy këste tremujore, përfshirë gjashtëmujorin, atëherë përqindja e realizimit kalon në 111.47%. Por duhet pasur kujdes, pasi buxheti vjetor është parashikuar në tre milion e gjashtëqind mijë euro, dhe ndarja në dy pjesë tregon se ekzekutimi i mjeteve për gjashtëmujorin është i kënaqshëm. Të hyrat vetanake bazohen në dy kategori kryesore: buxheti dhe financa, që sigurojnë rreth 50% të totalit. Për shembull, Drejtoria për Buxhetin dhe Financat ka grumbulluar shtatëqind e katërdhjetë e tre mijë euro, nga një parashikim vjetor prej një milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë eurosh. Nëse ndahet në dy pjesë, obligimi i ekzekutivit ishte që të realizohen 63,900 euro për gjashtëmujorin e parë, që përkthehet në një realizim prej 100%, ndërsa në planifikimin vjetor është 58% për këtë kategori. Nëse e ndajmë sërish, përqindja shkon në 116.24%, që është rezultat pozitiv. Gjendja është e kënaqshme edhe në sektorin e urbanizmit, i cili ka siguruar për gjashtë muaj 716,762 euro, nga një obligim vjetor prej një milion e pesëqind e tridhjetë e një mijë eurosh. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 46%, por nëse llogaritet sipas obligimeve të vendosura, del në 198.58%. Sa i përket shpenzimeve kapitale, gjendja duket e kënaqshme, megjithatë ekziston një specifikë që na shqetëson. Realizimi i investimeve kapitale nuk ka qenë i plotë, pasi një pjesë e madhe e mjeteve (rreth dy milion e dyqind e njëzet mijë euro) janë në proces ekzekutimi nga qeveria dhe përmbaruesit. Kjo ndikon në përqindjet e realizimit, por megjithatë nuk është gjendje e keqe. Totali i investimeve kapitale është tre milion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë euro, ku pjesa e përmbarimit është dy milion e dyqind e njëzet mijë. Një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë janë investime të tjera të realizuara. Nëse i krahasojmë me obligimet e gjashtëmujorit prej shtatë milionë e dyqind mijë eurosh, përqindja e realizimit është 44.57%.

Xhyljeta Imeri: Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Faleminderit për përgatitjen e raportit financiar. Dua të ndalem tek investimet kapitale, që prekin drejtpërdrejt nevojat e qytetarëve në sektorë të ndryshëm. Duke iu referuar tabelës dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë, më shqetëson fakti që arsimi parafillor dhe fillor ka zero investime kapitale, gjë që është shumë e keqe. Rreth 52% e investimeve kapitale janë për shkak të heqjes së mjeteve nga përmbaruesi, që do të thotë se projektet në procedurë prokurimi apo kontratat ekzistuese do të bartën obligim për vitin 2026. Fatkeqësisht drejtoresha nuk është këtu, por kam dëgjuar nga zyrtari i lartë i Thesarit se nga gushti në sistemin e menaxhimit të financave do të kërkohet zotim shumëvjeçar për prokurimet, dhe kjo mund të shkaktojë bllokadë. Si e menaxhoni këtë situatë?

Hysen Muzliukaj: I nderuar nënkryetar, kryesuese, kam vërejtur disa pasaktësi në tabelën 1. Krahasimi i inkasimit të të hyrave vetanake me planifikimin sipas drejtorive nuk përputhet me përqindjet që po na i shpjegon z. Fadil. Për shembull, vlera prej 192,554.382 euro nuk korrespondon me përqindjet që paraqiten. Gjithashtu, kemi kërkuar disa herë që listat e pagesave të ekzekutuara sipas procedurave përmbarimore nga Ministria e Financave - Departamenti i Thesarit, të bashkëngjiten me raportin, por kjo nuk është bërë ende. Është koha që kjo të bëhet një praktikë standarde për transparencë.

Erseka Hasani: Faleminderit, Fadil, për raportin financiar në mungesë të drejtoreshës. Dua të ndaj dy shqetësime. Së pari, subvencionet në arsimin parafillor janë vetëm 50 mijë euro, por janë shpenzuar vetëm 2,945 euro në gjashtëmujorin e parë. Kjo është e papranueshme, sidomos duke pasur parasysh se këto mjete janë dedikuara për nxënësit. Së dyti, nga 62 projektet në tabelë, vetëm 17 janë duke u realizuar, 30 janë në procedurë përmbarimore dhe pjesa tjetër nuk ka filluar ende. Kjo situatë është shqetësuese dhe duhet të adresohet me urgjencë.

Vesa Broja: Drejtoresha nuk është këtu, ndoshta nuk ka pasur kërkesa ose ndonjë pagesë ka ndodhur në korrik, prandaj nuk është përfshirë në raport.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2025 me propozimin e z. Muzliukaj që raportit t'i bashkangjitet lista e pagesave të ekzekutuara sipas procedurave përmbaremore nga Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit deri më dt. 30.06.2025.

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimit (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Raportin financiar për periudhën janar-qershor 2025 me propozimin që raportit t'i bashkangjitet lista e pagesave të ekzekutuara sipas procedurave përmbaremore nga Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit deri më dt. 30.06.2025 dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:45 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesja e Kuvendit

Merita PRETENI

Vesa BROJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0051646/25 dt. 22.08.2025

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, paragrafi 1 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë; nenit 62, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, nenit 13, të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës Nr. 12/2013; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **hënën** më **dt. 25.08.2025**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa
Seanca e 44

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Shqyrtimi i kërkesave të OJQ-ve për përkrahje financiare

Mbledhja mbahet në Sallën e Mediave duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesë BROJA